

Morën pjesë në trajnimin
e ushtrisë ukrainase,
Maqedonci dekoron
ushtarët e FSK-së



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SOT (E MËRKURË) HAPET APLIKIMI PËR SUBVENCIONIMIN
E TEKSTEVE SHKOLLORE PËR NXËNËSIT

EDHE KËTË VIT PRINDËRIT DO TË SUBVENCIONOHEN PËR TEKSTET E NXËNËSVE



Ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka bërë me dije të martën se edhe këtë vit prindërit do të subvencionohen për librat e nxënësve. Ajo ka thënë se prindërit

nga sot (e mërkurë) mund të aplikojnë në platformën "E-Kosova" për subvencionim. Në këtë kontekst, Nagavci ka treguar se për nxënësit prej klasës së parë deri në

të pestën, prindërit do të subvencionohen 80 euro, kurse për nxënësit prej klasës gjashtë deri në të nëntën, kompensimi do të jetë 110 euro

IKD-ja: QEVERIA DHE KUVENDI SHPËRFillin KUSHTETUESIN, CENOHEN TË DREJTAT E MIJËRA SHËRBYESVE CIVILË



Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka theksuar se mosmiratimi i Ligjit për Paga nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, paraqet shkelje të këtij aktgjykimi, shpërfillje të kësaj gjykate, shkelje

të Kushtetutës dhe cenim të të drejtave të dhjetëra-mijëra shërbyesve civilë. IKD-ja ka kërkuar nga Kuvendi dhe Qeveria që urgjentisht t'i nisin procedurat për ndryshimet e kërkuara nga Kushtetuesja në lidhje me këtë ligj

OPINION

FUNDI I QEVERISË KURTI MUND TË VULOSET NË URËN E IBRIT

Shkruan:
Milazim KRASNIQI



AKTUALE



NË BUJANOC SHFAQEN GRAFITE ME MBISHKRIMIN "VDEKJE SHQIPTARËVE"

DEDAJ DHE BISLIMI MARRIN PJESË NË SHËNIMIN E 23-VJETORIT TË MARRËVESHJES SË OHRIT

ABDIXHIKU "THUMBON PUSHTETIN": PËR PUNË NA KENI NEVE, PËR SULME ATA TË TJERËT

EKONOMI



VENDOSJA E KUOTAVE TATIMORE, HOTI: KAOS, PAMUNDËSON IMPORTIN ME ÇMIME TË LIRA

AUTORITETI I KONKURENCËS HAP PROCEDURË HETIMORE NDAJ KATËR OPERATORËVE KABLLORË PËR "MARRËVESHJE TË NDALUAR"

SPORT

KUKA I QUAN XHUDISTËT HERONJ: MBUSHËT RRATHËT OLIMPIKË ME MEDALJE

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja kërkon nga Turqia ta bindë Iranin t'i ulë tensionet në Lindjen e Mesme

STAMBOLL, 13 GUSHT - Shtetet e Bashkuara po i kërkojnë Turqisë dhe aleatëve të tjerë, të cilët kanë raporte me Iranin, që ta bindin atë t'i ulë tensionet në Lindjen e Mesme, ka thënë ambasadori amerikan në Turqi. Ambasadori Jeff Flake i ka bërë këto komente teksa rajoni i Lindjes së Mesme po përgatitet për sulme të mundshme nga Irani dhe aleatët e tij, në shenjë hakmarrjeje për vrasjen e Ismail Haniyeh, shefit politik të Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian dhe një komandanti të lartë të Hezbollahut, grupit libanez të shpallur organizatë terroriste nga Uashingtoni. Haniyeh është vrarë më 31 korrik

në Teheran të Iranit dhe për vrasjen e tij Irani dhe Hamasi kanë fajësuar Izraelin, i cili është duke luftuar me grupin radikal palestinez në Gazë që nga 7 tetori i vitit të kaluar. Izraeli nuk ka marrë përgjegjësinë për vrasjen e shefit politik të Hamasit. "Ne u kërkojmë të gjithë aleatëve tanë që kanë raporte me Iranin, që ta bindin t'i ulë tensionet dhe këtu përfshihet edhe Turqia. Ne po bëjmë gjithçka që mundemi që situata të mos përshkallëzohet", ka thënë Flake gjatë një debati në Stamboll.

ShBA-ja dhe Turqia kanë pasur raporte të tendosura vitet e fundit për shkak të aleancës së ShBA-së me kurdët sirianë që Turqia i cilëson terroristë, por edhe për shkak të blerjes së sistemeve ruse "S-400" nga Ankara, që ka shtyrë



Uashingtonin ta largojë Turqinë nga programi për blerjen e avionëve amerikanë "F-35". Megjithatë, Flake ka thënë se raportet ShBA - Turqi tash janë "më të mira".

Ai ka vënë në dukje "rolin

produktiv" që Turqia ka luajtur në atë që është konsideruar si këmbimi më i madh i të burgosurve në mes të ShBA-së dhe Turqisë që nga Lufta e Ftohtë, që është realizuar përmes Ankarasë në fillim të gushtit.

"Ata nuk ishin të përfshirë në negociata, por në anën logjistike dhe luajtën rol të rëndësishëm", ka thënë Flake.

Në qershor, në një intervistë për "Reuters", Flake kishte deklaruar se Turqia qëndron fuqishëm me Perëndimin dhe partneritetin e saj me ShBA-në. Por, gjatë debatit në Stamboll, Flake ka thënë se situata në Gaza është "shumë e vështirë" dhe retorika e presidentit turk Rexhep Taip Erdogan kundër Izraelit e ka bërë më të vështirë për Ankaranë që ta luajë rolin e ndërmjetësueses. Ai ka thënë se dallimet mes Ankarasë dhe Uashingtonit sa i përket Gazës janë zvogëluar pasi ShBA-ja "në mënyrë aktive" nisi të bëjë thirrje për armëpushim, por ka pranuar se ende ka mospajtime.

"Financial Times": Rusia trajnoi marinën për sulme bërthamore në Evropë në rast konflikti me NATO-n



LONDËR, 13 GUSHT - Marina ruse është e përgatitur t'i godasë vendet shumë brenda Evropës me raketa bërthamore. Një gjë e tillë është zbuluar nga dosjet sekrete të para nga "Financial Times", sipas të cilave, në një konflikt të mundshëm me NATO-n, do të shënjestroheshin caqe të largëta si bregdeti perëndimor i Francës dhe

Barrow-in-Furness në Mbretërinë e Bashkuar.

Në rreth tridhjetë dosje të paraqitura nga burime perëndimore për gazetën britanike, në hollësi jepen planet për pushtimin në shkallë të gjerë të Ukrainës, të cilat parashikonin mundësinë e një konfrontimi ushtarak me NATO-n.

Në këtë rast, marinës ruse do t'i duhej të godiste shumë përtej kufirit me vendet e aleancës me një seri sulmesh në të gjithë Evropën Perëndimore. Dosjet përmbajnë një simulim të një sulmi taktik me armë bërthamore në fazat e hershme të një konflikti me një fuqi të madhe botërore.

Miliarderët kërcënojnë të largohen nga Zvicra

BERNË, 13 GUSHT - Miliarderët po kërcënojnë të largohen nga Zvicra për shkak të një propozimi, sipas të cilit, banorët me një trashëgimi prej më shumë se 50 milionë frangash (53.1 milionë euro) do të paguanin një taksë prej 50-përqindësh, shkruan "Bloomberg".

Në një anketë të qershorit nga firma e auditimit "PwC", dy të tretat e pronarëve të bizneseve, trashëgimtarët e të cilëve mund të preken nga taksë e re, treguan se po konsideronin një transferim

parandalues të aseteve të tyre tek anëtarët e tjerë të familjes. Më shumë se gjysma thanë se po mendonin të largoheshin jashtë vendit. Ndërkohë, trashëgimia aktualisht tatohet vetëm në disa kantone. Zvicra aktualisht nuk ka taksë mbi trashëgiminë në nivel shtetëror. Disa kantone kanë një taksë të tillë, por bashkëshortët dhe fëmijët, pra vija e parë e trashëgimisë, përjashtohen në shumicën e rasteve. Shkalla e tatimit mbi trashëgiminë në disa kantone është maksimumi 3.5



për qind. Kundërshtarët e propozimit, përveç rrezikut që të pasurit thjesht të largohen, shohin edhe rrezikun e dëmtimit ekonomik. Ata paralajmërojnë se taksë e propozuar është aq e lartë sa trashëgimtarët e kompanive do të duhet t'i shesin asetet për ta paguar atë. Kjo do t'i rrezikonte vendet e punës, veçanërisht nëse blerësi do të ishte i huaj, sepse nuk do të kishte gjasa që ai ta mbante prodhimin në Zvicër të shtrënjtë.

Trumpi ngre padi kundër Departamentit të Drejtësisë, kërkon 100 milionë dollarë dëmshpërblim

UASHINGTON, 13 GUSHT - Donald Trump ka ngritur një padi kundër Departamentit Amerikan të Drejtësisë (DAD) për "persekutim politik", duke kërkuar 100 milionë dollarë dëmshpërblim për kontrollin e ushtruar në pronën e tij në Florida në vitin 2022, ku ishin gjetur dokumente qeveritare konfidenciale dhe të klasifikuara. Trumpi i ka akuzuar prokurorin e përgjithshëm, Merrick Garland dhe drejtorin e FBI-së, Christopher Ray, për shkëlqen e

"protokollit" të përdorur në rastet që përfshijnë ish-presidentë për ta dëmtuar atë.

"Garland dhe Ray nuk duhet të kishin autorizuar kurrë kërkimin në (Mar-a-Lago) dhe hetimin (penal) që pasoi", është thënë në padi, e cila kërkon 100 milionë dollarë dëmshpërblim me interes dhe 15 milionë dollarë të tjerë për tarifat ligjore.

Kandidati republikan në zgjedhjet presidenciale të nëntorit vazhdon të përsërisë, pa asnjë provë, se

demokratët kanë manipuluar sistemin e drejtësisë për ta dëmtuar atë.

Dy vjet më parë, FBI-ja kishte kontrolluar pronën e Trumpit në Palm Beach, Florida, si pjesë e hetimit të saj për keqpërdorimin e supozuar të ish-presidentit të dokumenteve të klasifikuara. Në qershor 2023, Trumpi është paditur për 37 akuza penale për trajtimin e dokumenteve, por çështja është hedhur poshtë muajin e kaluar.



SOT (E MËRKURË) HAPET APLIKIMI PËR SUBVENCIONIMIN E LIBRAVE PËR NXËNËSIT

Edhe këtë vit prindërit do të subvencionohen për librat e nxënësve



Ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, ka njoftuar të martën, se edhe këtë vit prindërit do të subvencionohen për librat e nxënësve. Ajo ka thënë se prindërit nga sot (e mërkurë) mund të aplikojnë në platformën “E-Kosova” për subvencionim. Në këtë kontekst, Nagavci ka treguar se për nxënësit prej klasës së parë deri në të pestën, prindërit do të subvencionohen 80 euro, kurse për nxënësit prej klasës gjashtë deri në të nëntën, kompensimi do të jetë 110 euro

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 GUSHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI) ka vendosur edhe këtë vit që librat për nxënësit të mos dërgohen falas nëpër shkolla për nxënësit, por që prindërit të kompensohen me para për t'i blerë tekstet shkollore. Kështu ka bërë me dije të martën në një konferencë për medie ministria e MASHTI-it, Arbërie Nagavci. Ajo ka treguar se deri te ky vendim kanë ardhur pas një mbledhje me drejtoritë komunale të arsimit. Nagavci ka thënë se prindërit do të mund të aplikojnë për subvencionim qysh nga sot (e mërkurë). “Konferencën po e mbajmë pasi përfunduar mbledhjen me drejtoritë komunale. Trajtuar gjithë punën e përbashkët deri më tani lidhur me

udhëzimet administrative, legjislationin, kalendarin e ri shkollor. Temë shumë me interes është furnizimi me tekste dhe mjete mësimore. Duke pasur parasysh rolin e jashtëzakonshëm të teksteve, dhe faktin që mbetet një nga burimet kryesore të vetme për mësimdhënien dhe mësimnxënien, edhe sivjet tekstet mësimore do të ofrohen sipas praktikës së vitit të kaluar: subvencionim të prindërve të cilët do të kenë mundësi të aplikojnë që nesër. Subvencionojmë edhe mjetet shkollore me proces transparent dhe që shmang mundësinë e çfarëdo keqmenaxhimi që ka ndodhur në të kaluarën. Aplikimi hapet nesër në ‘E-Kosova’. Besojmë se do të jetë shumë më lehtë pasi të gjithë prindërit që kanë hapur platformën, i kanë llogaritë aktive”, ka thënë ajo.

Më tutje, Nagavci ka thënë se lista me libra është marrë nga drejtoritë komunale të arsimit. “Për ta lehtësuar këtë proces, do të lansojmë edhe një video për mënyrën e aplikimit. Ky proces furnizimi si proces në MASHTI ka filluar që nga qershori i këtij viti kur kemi miratuar listën e teksteve të aprovuara. Kemi qenë në kontakt me drejtoritë komunale. Listat që kemi pranuar nga drejtoritë komunale do t'i publikojmë në faqe të ministrisë. Diskutoam që këto lista të bëhen publike në vende të dukshme”, ka thënë Nagavci.

Ajo ka treguar se për nxënësit prej klasës së parë deri në të pestën prindërit do të subvencionohen 80 euro, kurse për nxënësit prej klasës gjashtë deri në të nëntën kompensimi do të jetë 110 euro. “Sipas kërkesave që kemi pranuar nga drejtoritë komunale, sivjet kemi 218 mijë nxënës nga klasa 1 deri në të pestën, dhe nga klasa 1 deri 5 subvencionim do të jetë në vlerë prej 80 eurove, kurse për nxënësit prej klasës 6 deri në 9 do të jetë 110 euro. Në mënyrë që gjithçka të finalizohet me sukses është e rëndësishme bashkëpunimi me shkollat, prindërit dhe palët e tjera. Do të jemi në dispozicion në vazhdimësi për përgjigje në çdo pyetje”, ka thënë Nagavci.

Metoda e njëjtë ishte përdorur edhe vitin e kaluar dhe kishte pasur shumë kritika. Ndaj këtij vendimi ka reaguar Asociacioni i Komunave

të Kosovës (AKK).

Kolegji i drejtorëve komunalë, i cili funksionon në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, ka shprehur brengën për subvencionimin e teksteve shkollore për nxënësit. Ky kolegji ka bërë me dije se më 1 shtator nxënësit nuk do t'i kenë të gjitha librat shkollorë. Sipas tyre, do të përsëritet situata e vitit të kaluar. “1. MASHTI do vazhdojë me subvencionimin e teksteve shkollore. 2. drejtorët komunal të arsimit shprehën brengën që me 1 shtator nxënësit nuk do i kenë të gjitha librat shkollor, bazuar në kohën e shkurtë në dispozicion deri më 1 shtator dhe praktikën e vitit të kaluar”, është thënë në reagimin e kolegjiut. Drejtorët komunalë kanë kërkuar që procesi i shpërndarjes së teksteve mësimore të bëhet duke i dërguar drejtpërdrejtë nëpër shkolla. 3. Ka pasur kërkesa nga drejtorët komunal, bazuar në përvojat e tyre, që procesi i shpërndarjes së teksteve mësimore të bëhet duke i dërguar drejtpërdrejtë nëpër shkolla sepse MASHTI i posedon të gjitha informatat për numrin e nxënësve për secilën shkollë. 4. Përkundër vonesave në procedura nga ministria, drejtorët e DKA-ve u shprehën të gatshëm ta ndihmojnë procesin brenda kompetencave të tyre vetëm që nxënësit të kenë të gjitha tekstet shkollore në ditën e parë të fillimit të vitit të ri shkollor”, është thënë në reagimin e AKK-së.

Kastrati i PDK-së: Ky pushtet kriminalësh edhe këtë shtator vendosi ta vazhdojë dhunën ndaj nxënësve dhe prindërve

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ardian Kastrati, pas vendimit të MASHTI-it që do t'ua transferojë paratë prindërve edhe sivjet, në mënyrë që ata t'i blejnë pastaj tekstet shkollore për fëmijët e tyre për vitin e ri shkollor, ka thënë se ky pushtet “kriminalësh e banditësh të korruptuar vendosi sot ta vazhdojë dhunën psikike e fizike ndaj prindërve e nxënësve edhe këtë shtator”.

Kastrati ka shkruar në “Facebook” se Prokuroria Speciale duhet ta hetojë Nagavcin për tekstet. Sipas Kastratit, prindërit e nxënësit do të “dhunohen në radhët e gjata para librarive në temperatura të larta për shkak të tekave e agjendave personale të Nagavci”. “Ky pushtet kriminalësh e banditësh të korruptuar vendosi sot ta vazhdojë dhunën psikike e fizike ndaj prindërve e nxënësve edhe këtë shtator. Prindërit e nxënësit do të dhunohen në radhët e gjata para librarive në temperatura të larta për shkak të tekave e agjendave personale të Nagavci. Ne si Komision Hetimor do ta vazhdojmë punën në shtator. Prokuroria Speciale duhet ta hetojë Nagavcin për tekstet”, ka shkruar Kastrati.

Morën pjesë në trajnimin e ushtrisë ukrainase, Maqedonci dekoron ushtarët e FSK-së

PRISHTINË, 13 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka dekoruar me medalje ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës që kanë marrë pjesë në operacionin ndërkombëtar “Interflex”. “Me këtë rast, për performancën e jashtëzakonshme dhe kontributin e dhënë në kuadër të operacionit ‘Interflex’, ministri i dekoroi ata me medalje për ‘Pjesëmarrje në

Operacione Ndërkombëtare’. Maqedonci ka shprehur mirënjohje për ushtarakët ‘që me profesionalizmin, përkushtimin dhe angazhimin e treguar gjatë shërbimit në këtë operacion përfaqësuan denjësisht Republikën e Kosovë”, ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.

Sipas këtij njoftimi, Maqedonci ka thënë se Ukraina do të triumfojë përballë Rusisë. “Në

këto periudhë, mbështetja ofruar Ukrainës është qenësore që përballë agresorit e drejta të triumfojë”, citohet të këtë thënë Maqedonci.

Në këtë operacion ushtarakët e FSK-së për gjashtë muaj me radhë, përkrah ushtrisë britanike dhe dymbëdhjetë shteteve të tjera pjesëmarrëse, kanë ofruar trajnime për Forcat e Armatosura të Ukrainës në nivelin taktik dhe luftarak.





IKD-ja: Qeveria dhe Kuvendi shpërfillin Kushtetuesen, cenohen të drejtat e mijëra shërbyesve civilë

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka theksuar se mosmiratimi i Ligjit për Paga nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, paraqet shkelje të këtij aktgjykimi, shpërfillje të kësaj gjykate, shkelje të Kushtetutës dhe cenim të të drejtave të dhjetëra-mijëra shërbyesve civilë. Në këtë drejtim, IKD-ja ka kërkuar nga Kuvendi dhe Qeveria me urgjencë t'i nisin procedurat për ndryshimet e kërkuara nga Kushtetuesja në lidhje me këtë ligj

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PPrishtinë, 13 gusht - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka vlerësuar se mosmiratimi i Ligjit për Paga në sektorin publik nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, paraqet shkelje të këtij aktgjykimi, shpërfillje të kësaj gjykate, shkelje të Kushtetutës, cenim të të drejtave në shtesë të pagës sipas përvojës së punës të dhjetëra-mijëra shërbyesve civilë në Kosovë, si dhe krijohet një praktikë e dëmshme për promovimin e demokracisë. Sipas IKD-së, me vendimin e 23 dhjetorit të vitit 2023 Gjykata Kushtetuese kishte vendosur t'i shpallë në kundërshtim me

Kushtetutën e Kosovës disa dispozita të Ligjit për Paga në sektorin publik dhe të njëjtat i shpalli të pavlefshme. "Për disa të tjera, përveç që i shpalli në kundërshtim me Kushtetutën, kjo gjykatë urdhëroi Kuvendin e Kosovës që për të njëjtat t'i nisë ndryshimet ligjore të nevojshme e të domosdoshme në mënyrë që të korrigjohen dispozitat e papërshtatshme brenda një afati prej gjashtë muajve prej se kur aktgjykimi në rastin numër KO79/23 hyri në fuqi më 1 shkurt 2024", është thënë në reagimin e IKD-së.

IKD-ja ka vlerësuar se ky vendim i Kushtetueses ishte një hap i rëndësishëm në mënyrë që reforma e nevojshme në sektorin publik të përcillet me siguri për punonjësit në mënyrë që këta të

fundit të kompensohen në mënyrë të drejtë për përvojën dhe angazhimin e tyre profesional. "Gjykata rrëzoi dispozitën ku dhjetëra-mijëra shërbyesve civilë iu përgjysmua e drejta e shtesës së përvojës së punës, nga zero pikë pesë për qind (0.5 për qind), në zero pikë njëzet e pesë për qind (0.25 për qind) në vit, duke e përgjysmuar shtesën e përvojës së punës për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para, rrjedhimisht lartësinë e pagës për të gjitha kategoritë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunë sve që hyjnë në fushëveprimin e ligjit të kontestuar, përkatësisht duke përcaktuar shtesë të përvojës dyfish më të ulët në krahasim me legjislacionin paraprak sa i përket pesëmbëdhjetë (15) viteve të para të përvojës së punës. Megjithatë,

përkundër dijeisë së Qeverisë dhe Kuvendit, e për më tepër që një aktgjykim i tillë iu dorëzohet të dy institucioneve dhe publikohet në faqen zyrtare të GjK-së, është shqetësuese dhe e papranueshme që prej kalimit të më shumë se gjashtë muaj e 13 ditë që nga shpallja e këtij aktgjykimi, asnjë nga institucionet e lartcekura nuk kanë ndërmarrë asnjë hap konkret për t'i përmbushur detyrimet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese. Në vend që të vepronin për t'i adresuar problemet e evidentuara dhe për ta përfshirë Projektligjin për pagat në programin legjislativ për vitin 2024, institucionet e Kosovës kanë shpërfillur kërkesat e GjK-së", është thënë në reagim.

IKD-ja ia ka rikujtuar Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, se përgjatë shtatë muajve të këtij viti mosinicimi i këtij projektligji dhe moshyrja në fuqi brenda afatit të përcaktuar nga GjK-ja ka pasur dhe vazhdon të ketë pasoja të rënda për të drejtën e pagesës për dhjetëra mijëra shërbyes civilë në Kosovë. Këta punëtorë, të cilët

kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në funksionimin e institucioneve dhe shërbimeve publike, janë të privuar nga shtesa në bazë të përvojës së punës, e cila para hyrjes në fuqi të Ligjit për Paga, pasqyronte përvojën e tyre dhe angazhimin profesional. Sipas IKD-së, një situatë e tillë jo vetëm që cenon integritetin dhe sigurinë e sistemit të pagave në sektorin publik, por minon besimin e qytetarëve në institucionet e shtetit dhe në aftësinë e tyre për ta zbatuar dhe respektuar ligjin.

"Mosinicimi deri në këtë moment i këtij ligji ka ndikim të thellë dhe të gjerë në jetën sociale dhe ekonomike të shërbyesve civilë, pasi që vendosja e kriterëve të reja jokushtetuese te shtesat mbi përvojën, ka rënduar jetesën e tyre. Mosinicimi i ligjit ka pasoja të drejtpërdrejta në mirëqenien dhe stabilitetin social të mijëra familjeve që mbështeten në këto paga për t'i siguruar nevojat e përditshme dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve të tyre", është thënë në reagimin e IKD-së.

BE-ja sërish me qëndrim të njëjtë për Urën e Ibrit: Do të futet në agjendën e dialogut Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 13 GUSHT - Bashkimi Evropian (BE) do ta fusë çështjen e urës së Ibrit në agjendën e bisedimeve të procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kështu ka deklaruar zëdhënësja e BE-së, Nabila Massrali. “BE-ja planifikon ta vendosë statusin e urës në agjendën e takimit të ardhshëm të dialogut”, ka thënë Massrali për “RTV21”. Edhe më herët, përfaqësues të BE-së janë deklaruar kundër hapjes së urës së Ibrit për qarkullim për automjete. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ditë më parë kishte

thënë se miqtë e Kosovës (Bashkimi Evropian dhe Quint-i) kishin shkuar te kryeministri Albin Kurti për t’i thënë: “Mos e bëj këtë, mos bëj lëvizje të njëanshme, mos e hap urën”. “Por ai duket i vendosur ta bëjë këtë. Prandaj thamë, ‘jo, do të ketë efekte shumë negative’. Kërkojmë nga autoritetet ta parandalojnë dhe t’i shmangin hapat që do të çojnë në konfrontime dhe përshkallëzim më të madh. Sepse i lëndon njerëzit në terren dhe ju dhemb edhe juve, sepse Kosova është në

masat e BE-së dhe në disa masa të ShBA-së për shkak të ndërmarrjes së përsëritur dhe të provuar të lëvizjeve që çojnë në përshkallëzim. Nuk i ndihmon askujt, përkundrazi, ndikon shumë negativisht te një numër i madh njerëzish”, kishte thënë Stano. Autoritetet e Kosovës kanë nisur procedurat për testimin e fuqisë mbajtëse të Urës së Ibrit, si hap para hapjes së saj për qarkullim të automjeteve. Ky insistim është përballur me kundërshtim të bashkësisë ndërkombëtare, përfshirë edhe Amerikën.



Abdixhiku “thumbon pushtetin”: Për punë na keni neve, për sulme ata të tjerët



PRISHTINË, 13 GUSHT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka kritikuar pushtetin për sulmet ndaj medieve, ambasadave dhe

gjyqtarëve. Abdixhiku në “Facebook” ka publikuar pamje të hapësirave shëndetësore që janë rinovuar dhe që janë në renovim nga qeverisja e

LDK-së në Prishtinë. Duke “thumbuar” njerëzit e pushtetit të Albin Kurtit, Abdixhiku ka thënë se ata janë për sulme, kurse LDK-ja për punë.

“Me hapësirat e reja shëndetësore të renovuara e në renovim, 10 sosh të përfunduara deri më tani. Për konferenca me sulme ndaj mediave, bizneseve, ambasadave,

gjyqtarëve, mësuesve e praktikisht secilit që mendon ndryshe, i keni ata të tjerët. Ne, ndërsa, vazhdojmë”, ka shkruar Abdixhiku. Ndaj deklaratës së Abdixhikut ka reaguar deputeti i Lëvizjes së Vetëvendosjes, Mefail Bajqinovci. Bajqinovci në “Facebook” ka listuar disa nga “dështimet”, sipas tij, të LDK-së në kryeqytet. Ai ka përmendur qentë endacakë, papastërtinë dhe mbeturinat, kaosin në trafik dhe 50 milionë eurot që, sipas tij, i teprojnë çdo vit kryeqytetit. “Lumiri thotë se ne po renovojmë në kryeqytet. Nën qeverisjen e LDK-së, sot në Prishtinë fëmijët nuk guxojnë të shkojnë në shkolla fillore pa prindër sepse qentë endacak i sulmojnë. Mbi 600 sulme të qenve endacakë kanë ndodhur në kryeqytet në 6 muajt e fundit. Kur më shumë papastërti nuk ka pasur Prishtina – mbeturinat e kanë mbuluar kryeqytetin. Bllokimi i rrugëve ka shkaktuar kaos në trafik. Skandalet dhe keqpërdorimet i shohim çdo ditë në media për komunën e Prishtinës. Mos ta harrojmë ‘arkitektin e qytetit’. Dhe për fund, çdo vit në Prishtinë, LDK-së i teprojnë mbi 50 milionë euro. Ky është ‘renovimi’ i LDK-së”, ka shkruar Bajqinovci.

Më tutje, IKD-ja ka kërkuar nga Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës, që në afat sa më të shpejtë dhe me urgjencë t’i nisin procedurat për ndryshimet e kërkuara nga GjK-ja, t’i përfshijnë të gjitha palët e interesit, në veçanti Sindikatën e

Shërbyesve Civilë, shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë të interesuar në mënyrë që ligji i ardhshëm të jetë në pajtim me kërkesat e precizuara në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Vetëm në këtë mënyrë mund të

sigurohet që të drejtat e shërbyesve civilë do të mbrohen dhe të garantohet një sistem i drejtë dhe transparent i pagave. “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe

individët në Republikën e Kosovës, pasi ato përfaqësojnë interpretimin përfundimtar kushtetutës. Mosrespektimi i këtyre vendimeve përbën shkelje të rëndë të aktit më të lartë juridik të vendit, duke krijuar një

praktikë të rrezikshme. Një sjellje e tillë rrezikon të krijojë një precedent negativ që dobëson rendin kushtetues dhe stabilitetin e përgjithshëm të funksionimit të shtetit ligjor”, është thënë në reagimin e IKD-së.

Në Bujanoc shfaqen grafitë me mbishkrimin “vdekje shqiptarëve”

BUJANOC, 13 GUSHT - Një ditë pas protestës, në Bujanoc janë shfaqur grafitë me mbishkrimin “vdekje shqiptarëve”. Kështu ka bërë me dije të martën kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar, Nevzad Luftiu. Luftiu ka thënë se këto grafitë qytetarët i kanë parë në oborrin e Shtëpisë së Shëndetit në Bujanoc. Me

këtë rast, ai i ka ftuar organet e rendit ta zbulojnë autorin e tyre dhe të merren masat për këtë veprim. “Në oborrin e Shtëpisë së Shëndetit në Bujanoc gjatë ditës së sotme qytetarët e kanë parë këtë grafit ‘vdekje shqiptarëve’. Ftoj organet e rendit që ta zbulojnë autorin dhe të merren masa”, ka shkruar Luftiu në “Facebook”.

Të hënën është protestuar në Bujanoc kundër diskriminimit të shqiptarëve nga Serbia. Para protestuesve ka folur edhe kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar, Nevzad Luftiu, i cili ka thënë se në Serbi janë 24 komunitete por, sipas tij, asnjëri nuk i ka problemet dhe sfidat që i ka komuniteti shqiptar.



Totaj: Situata është në kontroll në Prevallë, nuk janë duke u djegur drunjtë e lartë

PRIZREN, 13 GUSHT - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka thënë se, pas një takimi me shtabin emergjent, është njoftuar se situata është në kontroll në Prevallë, pas zjarreve të mëdha që u përhapën për ditë me radhë. Ai ka thënë se nuk janë duke u djegur drunjtë e lartë, prandaj, rrjedhimisht rreziku është më i vogël.

Totaj ka shtuar se me ekipin e tij të martën ka vizituar atë zonë për ta parë nga afër gjendjen e krijuar. “Meqenëse kemi të bëjmë me Park Nacional, nënkuptohet se edhe institucionet e nivelit kombëtar, por edhe ndërkombëtar si KFOR-i, kanë obligime dhe shtabi është në koordinim të plotë me të gjithë aktorët e autorizuar që po merren me

këtë çështje, derisa gjendja po monitorohet dhe nuk pritet eskalim. Sot planifikojmë intervenim dhe lokalizim të zjarrit për ta pasur në kontroll dhe për t’i minimizuar pasojat eventuale. Falënderoj të gjithë pjesëtarët e institucioneve lokale dhe qendrore për kontributin që po japin për menaxhimin e situatës së krijuar!”, ka thënë Totaj.



Koci, LV-së: Kërkojeni te vetja juaj shkakun e vetëvrasjes së Astrit Deharit, do t’ju vrasë gjaku i tij

PRISHTINË, 13 GUSHT - Zyrtari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Gani Koci, ka kritikuar partinë në pushtet për shfrytëzimin e rastit të Astrit Deharit për qëllime politike. Ai ka thënë se LV-ja po kërkon drejtësi për shkak se zgjedhjet nacionale janë afër.

“Era zgjedhje po vjen! Janë quar në këmbë nekrofilët politikë – nekropolitikanët e LV-së (siç i quan B. Latifi) dhe po ua lëkundin eshtrat të vdekurve! Të tillët vetëm mbi të vdekurit krijojnë kauza. Po ku ishit o mjeranë më herët, po tash në fund të mandatit po kërkon, gjoja, ‘drejtësi për Astrit Deharin’?. Kërkojeni te vetja juaj shkakun e vetëvrasjes së tij.

Sepse ju përfituat dhe përpigëni akoma të përfitonin prej gjakut të tij, tashmë edhe i vdekur. Pse dogjëti IML-në, më shumë se dy herë dhe pse vodhët mostrat dhe i kthyet ato pa dhënë kurrë asnjë shpjegim? Veprimet tuaja po ngjajnë në atë kur hajni thotë kapeni hajnin! Kot akuzoni të tjerët. Ju jeni vrasësit e Astritit. Ka me ju vra gjaku i tij”, ka shkruar Koci në “Facebook”.

Lëvizja Vetëvendosje ka implikuar Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Policinë e Kosovës dhe prokurorinë për arrestimet e aktivistëve të saj lidhur me sulmin kundër Kuvendit të Kosovës, ndërsa urdhri, sipas tyre, ka ardhur nga



ish-presidenti Hashim Thaçi dhe ish-kryeparlamentari Kadri Veseli.

Në një konferencë për medie të hënën, përfaqësuesi i këtij subjekti politik në Komisionin

Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Sami Kurteshi, ka deklaruar se ky rast është bërë me urdhër politik dhe inskenim për t’i fshehur autorët e vërtetë të këtij rasti. Ndërsa anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Përparim Gruda, i ka kërkuar qeverisë t’i ndalë “lojërat dhe propagandën politike” në rastin Dehari, teksa ka thënë se Vetëvendosja ka dorë në moszbardhjen e këtij rasti.

Gruda, në një konferencë për medie, e ka quajtur “show politik” dhe vazhdimësi të keqpërdorimit të rastit Dehari, konferencën e Lëvizjes Vetëvendosje të hënën para Prokurorisë Speciale.

Bunjaku-Rexhepi: Në Klinikën Emergjente nuk ka karrige për pacientët, pushteti propagandon me rastin Dehari



PRISHTINË, 13 GUSHT - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se spitalet e Kosovës janë duke u përballur me mungesë të pajisjeve elementare. Po sipas saj, pushteti i Albin Kurtit vazhdon propagandën me rastin e Astrit Deharit dhe hapjen e Urës së Ibrit.

Ajo e ka quajtur Kurtin demagog që ka degraduar gjithçka në Kosovë. “Në Klinikën Emergjente nuk ka karrige për pacientë.

Spitalet e Kosovës po përballen me mungesë të pajisjeve elementare, mungesë të barnave esenciale, madje ankesa e fundit e një familjari të pacientit më shkruan se, po mungojnë karriget në Klinikën Emergjente për bartjen e pacientëve, por pushteti i qeverisë Kurti 2 vazhdon me propagandën me rastin e supershfrytëzuar elektoralisht, ‘rastin Dehari’, si dhe me hapjen e Urës së Ibrit”, ka shkruar ajo në “Facebook”.

Bunjaku-Rexhepi ka theksuar se

qeveria e drejtuar nga “kryedemagogu” Albin Kurti ka degraduar shëndetësinë, ekonominë, arsimin dhe çdo gjë tjetër. Po ashtu, ajo ka thënë se Kurti e ka futur Kosovën në sanksione dhe e ka izoluar në marrëdhëniet diplomatike me Perëndimin. “O kryedemagog, pajisi spitalet me gjërat esenciale! Dorëzohu dhe ik në shtëpi, se nuk je për qeverisje! Nuk mbahet shteti me rima poetike e patetike!”, ka shkruar deputetja e LDK-së.

KRU “Gjakova”: Për shkak të keqpërdorimit, konsumatorët nuk kanë ujë as për pije

GJAKOVË, 13 GUSHT - Kompanie Regjionale e Ujësjetës (KRU) “Gjakova” ka bërë apel që uji i pijshëm mos të shfrytëzohet për ujitje të arave, larje të automjeteve dhe pastrim të rrugëve e trotuareve pasi, sipas kësaj kompanie, ka

konsumatorë që për shkak të keqpërdorimit, nuk kanë ujë as për pije dhe nevoja elementare higjienike. “Uji i pijshëm nuk duhet të shfrytëzohet për ujitje të arave, larje të automjeteve dhe pastrim të rrugëve dhe

trotuareve, sepse ka konsumatorë që për shkak të keqpërdorimit, nuk kanë ujë as për pije dhe nevoja elementare higjienike. Kursejani ujin gjatë ditëve të nxehta”, është thënë në apelin e KRU “Gjakova”.



Dedaj dhe Bislimi marrin pjesë në shënimin e 23-vjetorit të marrëveshjes së Ohrit

SHKUP, 13 GUSHT - Ish-ambasadori i Kosovës së Maqedonisë së Veriut, Gjergj Dedaj, i shoqëruar nga veprimtari Sali Bislimi, ka qëndruar të martën në Shkup. Ai është takuar me liderin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ish-kryeministrin Talat Xhaferi dhe përfaqësues të tjerë të partive politike me rastin e 23-vjetorit të marrëveshjes së Ohrit.

Dedaj ka bërë me dije se në shënimin e kësaj marrëveshje historike kanë marrë pjesë me ftesë të Frontit Evropian. “Serish në Shkup, rikthimet janë kod i Gjergj Kastriotit! Me rastin e 23-vjetorit të marrëveshjes historike të Ohrit, të nënshkruar më 13 gusht 2021, ndërmjet forcave kryesore politike maqedonase dhe shqiptare, me ndërmjetësimin e ShBA-së dhe BE-së, i shoqëruar nga

veprimtari Sali Bislimi, morëm pjesë në këtë festë të madhe të Frontit Evropian të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kishim nderim të takojmë liderin Ali Ahmeti, pastaj Talat Xhaferin, Artan Grubin, Zijadin Selen, Bujar Osmanin dhe shumë deputetë, ish-ministra dhe kryetar të komunave të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut!”, ka shkruar Dedaj në “Facebook”.



Fundi i qeverisë Kurti mund të vuloset në Urën e Ibrit



Shkruan: Milazim KRASNIQI

1. Qeverisë Kurti i është lejuar nga faktorët ndërkombëtar mbajtja e zgjedhjeve për kryetarët e komunave në veri. Mandej iu kërkua të mos bëhej inaugurimi në formën që u bë. Të huajt e kishin menduar mbajtjen e zgjedhjeve si presion ndaj Serbisë, jo si pushtet real të shqiptarëve në ato komuna. Prandaj me inaugurimin e kryetarëve të komunave u prishë skenari. Meqë u konsiderua se qeveria Kurti e prishi lojën, Bashkimi Evropian vendosi masa kundër Kosovës. Në fakt, ata e kanë futur Kurtin në kurth, për t’ia shtuar presionin për

Asociacionin. Ai ka menduar se po ia ushqejnë iluzionet sovraniste! Prandaj sukcesi me kryetarët në katër komunat veriore, po qe se argëtohem me sintagmat e Kurtit është “sukses katastrofal.” Megjithatë, më pak për Kurtin, më shumë për Kosovën.
2. Sulmi terrorist në Banjskë e kthjelloi atë që dihet që nga viti 1999: armata e Serbisë nuk guxon të hyjë në Kosovë. Prandaj fitorja e Kosovës përballë sulmit terrorist në Banjskë ishte e lehtë, meqë KFOR ishte aty. Definitivisht është e qartë: armata e Serbisë mund të hyjë në Kosovë vetëm nëse e lejon KFOR-i. A mund ta lejojë KFOR-i? Në ndonjë situatë jonormale, si mjet presioni mbi Kosovën, KFOR edhe mund ta lejojë kthimin e

qindra ushtarëve të Serbisë, ashtu si parashihet në rezolutën 1244 të KS të OKB-së. Por ajo mund të ndodhë vetëm në rast se Kosova del komplet nga shinat e partneritetit me NATO-n/KFOR-in. Fjala vjen, nëse provokon konflikt të armatosur me KFOR-in, për Urën e Ibrit.
3. Çështja e dinarit, mbyllja e postave të Serbisë u mundësua, duke mbylll pjesërisht sytë prezencë ndërkombëtare. Kjo u bë për ta mbyllur informalitetin dhe ndikimin direkt të Serbisë, para se të formohet Asociacioni, sepse Asociacioni, kurdo që të formohet, duhet të jetë vetëm brenda sistemit kushtetues të Kosovës. Por arroganca e qeverisë Kurti edhe këtë akord të heshtur po e

shndërron në konflikt me partnerët ndërkombëtar, për nevoja propagandistike, elektorale. Edhe këtë veprim procedural, po e shndërron në “sukses katastrofal.”
4. Edhe hapja e Urës së Ibrit për vetura mbase do të mund të lejohej si simbolikë, për të dhënë idenë e integritetit të serbëve, para se të formohet Asociacioni. Por hapja do të mund të bëhej me koordinim e jo si arrogancë e qeverisë Kurti. Thjesht, hapja e Urës së Ibrit ka të bëjë me KFOR-in dhe me prezencën ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, sepse KFOR është autoritet më i lartë se sa qeveria e Kosovës në aspektin e sigurisë. Pse u krijua klima e konfrontimit me

KFOR-in? Për të kënaqur pasionet e militantëve-injorantëve? I kënaq përkohësisht ato pasione të militantëve-injorantëve, ama politika të shndërrohet, siç u shndërrua tashmë, në sukses katastrofal.
5. Në këtë klimë konfrontimi të qeverisë Kurti me KFOR-in, me BE-në, me ShBA-në, hapja e Urës së Ibrit mund të bëhet vetëm me dhunë. Nëse provokohet dhunë, qeveria e Kosovës mbetet përgjegjëse dhe bartë pasojat. Pra në këtë rast qeveria do të bartte pasojat, jo Kosova. Prandaj armiqhtë e kësaj qeverie do ta inkurajonin që të tentonte ta hapte Urën e Ibrit me dhunë. Në rast të dhunës së provokuar prej saj, në atë urë do të vulosej fundi i saj.

Nënshkruhet kontrata për rehabilitimin e rrugës Kërpimeh-Bajgorë-Mitrovicë, vlera 4 milionë euro

PRISHTINË, 13 GUSHT - Zëvendësministri i Infrastrukturës, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Hysen

Durmishi, ka bërë me dije se është nënshkruar kontrata për rehabilitimin e rrugës Kërpimeh - Bajgorë -

Mitrovicë. Durmishi ka treguar se ky projekt kap vlerën e katër milionë eurove. “Rruga regionale R129, Kërpimeh -

Bajgorë - Mitrovicë, është projekt që arrin vlerë totale prej 4 milionë euro”, ka shkruar Durmishi në “Facebook”.



Ambasadori gjerman do ta hapë Forumin e Dytë Ekonomik Gjermano-Kosovar

PRISHTINË, 13 GUSHT - Drejtoresha ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Nora Hasani, është takuar me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde dhe zëvendësin e tij, Matthias Conrad, për të diskutuar për Forumin e Dytë Ekonomik Gjermano-Kosovar.

Ambasadori Rohde do ta hapë zyrtarisht këtë forum, i cili do të mbledhë në Prishtinë liderë të biznesit dhe politikanë nga Gjermania dhe Kosova për të diskutuar për të ardhmen e marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve.

Forum, i organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare dhe Komiteti Lindor i Ekonomisë Gjermane, do të mbahet më 2 dhe 3 tetor në Prishtinë.

Në fillim të tetorit Prishtina pritet të bëhet qendra e bashkëpunimit gjermano-kosovar, pasi ky forum do të zhvillohet menjëherë pas ngjarjes rajonale SUBEX - Supplier Expo, që mbahet më 1 tetor në Prishtinë dhe bashkëorganizohet nga tri oda gjermane: Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, Oda Ekonomike Gjermane e Maqedonisë së Veriut dhe



Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri. "Forum i Ekonomik Gjermano-Kosovar do të mirëpresë mbi 300

pjesëmarrës dhe ekspertë të industrisë nga Gjermania dhe Kosova. Ngjarja do të ofrojë një program tërheqës me diskutime në panele, intervista

me ekspertë, podcast-e, masterclass-e, vizita në kompani dhe shumë më tepër. Gjermania mbetet investitorja më e madhe e huaj në Kosovë (me 190 milionë euro investime të huaja direkte më 2023), donatorja më e madhe bilaterale që nga paslufta, partnerja kyçe tregtare dhe shteti me diasporën më të madhe kosovare. Forumi i Parë Ekonomik Gjermano-Kosovar, i cili u mbajt në vitin 2022, rezultoi me investimin 20 milionë euro në sektorin e automotivës", ka njoftuar Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare.

Vendosja e kuotave tatimore, Hoti: Kaos, pamundëson importin me çmime të lira

PRISHTINË, 13 GUSHT - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka reaguar ndaj një udhëzimi administrativ të vendosur nga Qeveria e Kosovës për vendosje të kuotave tatimore për import.

Ai ka vlerësuar se ky udhëzim krijon kaos dhe pamundëson importimin e mallrave me çmime të lira. "Udhëzimi Administrativ 06/2024 për vendosjen e kuotave tatimore në import, i miratuar nga Qeveria më 07.08.2024, do të shkaktoj kaos në import, duke e rënduar koston e shportës së konsumit. Është e pakuptueshme se si disa nga odat ekonomike nuk po reagojnë për këtë anomali në politikat tregtare. Në vend të masave për mbështetje të prodhuesve vendor për të zëvendësuar mallrat nga importi, këta qeveritarë miratojnë udhëzime për administrim të importeve", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Më tutje, ai ka thënë se qeveria Kurti nuk ka asnjë politikë ekonomike përmbajtësore. "Fatkeqësisht, në këto katër vite qeverisje nuk ka pasur asnjë politikë ekonomike substanciale. Si rezultat, deficit tregtar është thelluar për 2.2 miliardë euro. Sikur të ishin zbatuar vetëm masat

e politikës fiskale 2.0, e lënë në gjysmë në qeverinë Mustafa në vitin 2017, situata ekonomike do të ishte krejt ndryshe", ka shkruar Hoti.

Për t'i kujtuar ato masa, Hoti ka publikuar listën e masave nga pakaja fiskale 2.0 që ishte miratuar në qeverinë Mustafa në vitin 2017, por që nuk ishte zbatuar për shkak të ndryshimeve në qeverisje:

1. Lirimi nga tatimi doganor për produktet që konsiderohen si lëndë e parë për prodhim që nuk prodhohen në vend, sipas regjistrit të prodhuesve në ATK.

2. Heqja e normës së akcizës në mazut për prodhim dhe shqyrtimi i formave të riimbursimit të akcizës në verë.

3. Ndryshimi dhe plotësimi i listës së produkteve që i nënshtrohen normës së reduktuar 8 për qind të TVSh-së për aktivitetet kulturore, artistike, sportive, turistike, akomodim dhe rekreacion dhe përpunimi i peshkut.

4. Udhëzimi Administrativ për Pushimet Tatimore për nxitjen e investimeve në sektorë të veçantë me potencial për zhvillim dhe punësim në Kosovë: bujqësi (agropcesim), turizëm dhe IT, për një periudhë të caktuar kohore.

5. Nxjerrja e aktit nënligjor për kushtet e caktuara nën të cilat pranohen për qëllime tatimore humbjet nga prishja, avullimi apo humbja e peshës së produkteve sipas normativave të BE-së.

6. Krijimi i kodeve të reja tarifore për disa produkte, sipas praktikave të BE-së.

7. Krijimi i listës së rejtingut të kompanive sa i përket përbushjes së obligimeve tatimore, respektimit të legjislacionit të punësimit dhe legjislacionit tjetër, e cila listë përfiton trajtim të veçantë në procedurat administrative.

8. Licencat – krijimi i portalit të transparencës.

9. Fiskalizimi.

10. Rishikimi i Ligjit për lojërat e fatit me qëllim të harmonizimit të kërkesave ligjore me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe harmonizimin me institucionet tjera.

11. Lista e prodhuesve vendor, të cilët marrin trajtim të veçantë administrativ.

12. Ndryshim/plotësimi i Ligjit për të ardhurat e korporatave dhe Ligjit për të ardhurat personale për të adresuar: (i) tatimin e kompanive të sigurimit dhe (ii) rishikimin e tatimit të mbajtur në burim për grumbulluesit e produkteve bujqësore.

13. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për TVSh-në për të adresuar tatimin për aktivitetet e transportit rrugor ndërkombëtar të pasagjerëve, me qëllim të harmonizimit të plotë me Direktivat e BE për TVSh.

14. Trajtimi i importit të telefonave mobil përmes aktiviteteve të shtuara dhe të përbashkëta të ATK-së dhe Doganës së Kosovës.

15. Rregullimi i tregut të shitjeve online.

16. Rishikimi gradual i akcizës në pije të gazuara dhe jo të gazuara.



17. Trajtimi i importit të pajisjeve prodhuese në formë parçiale.

18. Akciza në alkoolin etilik për përdorim në mjekësi.

19. Trajtimi i mostrave me rastin e zhdoganimit. 20. Nxjerrja e Udhëzimit Administrativ për skemën e veçantë për arin e investueshëm me qëllim të trajtimit të sektorit të arit në përputhje me praktikën ndërkombëtare. 21. Ruajtja e konkurrencës së drejtë përmes shqyrtimit të monopoleve potenciale në treg.

Edhe AKB-ja kundërshton vendosjen e kuotave për import të produkteve

Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka kundërshtuar Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për përcaktimin e kuotave për import të produkteve. AKB-ja ka vlerësuar se ky udhëzim është në kundërshtim me parimin e ekonomisë së tregut të lirë. Sipas



AKB-së, ky udhëzim do t'i rritë çmimet nga importi për konsumatorët si dhe nxitë korrupsionin nga burokracia për të marrë leje për import. "Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) kundërshton Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) për Udhëzimin Administrativ nr. 06/2024 për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për administrimin e kuotave të importit. Agim Shahini, kryetar i AKB-së, ka thënë se kjo metodë i përket ekonomisë së planifikuar nga sistemi i kaluar që është në kundërshtim me parimin e ekonomisë së lirë të tregut të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky udhëzim do t'i rritë çmimet nga importi për konsumatorët si dhe nxitë korrupsionin nga burokracia për të marrë leje për import të produkteve të caktuara në bazë të kuotizimit. AKB-ja i kërkon MINT-it t'i lërë bizneset e lira në konkurrencë të hapur pa ndërhyrjen dhe favorizime për ndonjë operator ekonomik", është thënë në reagimin e AKB-së.

Autoriteti i Konkurrencës hap procedurë hetimore ndaj katër operatorëve kabllorë për "marrëveshje të ndaluar"

PRISHTINË, 13 GUSHT - Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka nisur hetimet kundër "Art Motion", "Kujtesës", "Telkosit" dhe "ISP Broadcast", pasi dyshohen se janë marrë vesh për fiksime të çmimeve.

Lajmin e ka konfirmuar Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës. "Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës njofton

opinionin publik se me datë 08.08.2024 ka nisur një hetim të thelluar lidhur me dyshimin e bazuar për arritjen e marrëveshjes së ndaluar/kartel për fiksimin e çmimeve dhe ndarjen e tregjeve në sektorin e telekomunikacioneve nga disa operatorë me ndikim në treg. Konkluzioni për hetim të thelluar përfshin kompanitë:



'Artmotion sh.p.k', 'Kujtesa Net sh.p.k', 'Telkos l.l.c' dhe 'ISP

Broadcast sh.p.k'. Gjatë shqyrtimit janë grumbulluar dëshmi të konsiderueshme që tregojnë se këto kompani kanë krijuar një sistem për të fiksuar çmimet, për të ndarë tregun dhe për të kufizuar opsionet e disponueshme për konsumatorët", është thënë në njoftimin e AKK-së.

Këto veprime, sipas AKK-së, jo vetëm që rrisin çmimet për

konsumatorët, por krijojnë një mjedis të padrejtë për bizneset e tjera që operojnë në të njëjtin sektor, duke zvogëluar konkurrencën dhe duke shtrembëruar tregun. "Ky hetim synon të sigurojë se çdo veprim i tillë që dëmton konkurrencën do të trajtohet sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës", është thënë në këtë njoftim.

Ndarja e madhe e mbretërorëve



Diplomacia nuk është pjesë e karakterit të tij, por kur bëhet fjalë për kokëfortësinë, Princi Harry është i pakalueshëm.

Duka i Sussex është i bindur se është e drejta e tij, e gruas së tij Meghan dhe fëmijëve të tyre Archie, 5 vjeç dhe Lilibet Diana, 3 vjeç, që të kenë shoqërim të garantuar, të paguar me para publike kur kthehen në shtëpi. Edhe pse ai nuk ka qenë më mbretëror i lartë që nga viti 2020, në të cilin mbaronin afatet për privilegjet e tij mbretërore, përfshirë atë për sigurinë. Frika e tij është se pa mbrojtje të duhur dhe me urrejtjen sociale që shtohet në mënyrë të pakontrolluar, gruaja e tij rrezikon jetën: për këtë arsye Meghan nuk është kthyer në Mbretërinë e Bashkuar që nga viti 2022. Ajo e tha këtë më 25 korrik në dokumentarin Tabloid on Trial, duke akuzuar tabloidet britanike se kanë nxitur urrejtjen racore, e shtyrë edhe prej qarqeve

ekstremiste (Meghan, nëna e së cilës është afrikano-amerikane, ka thënë vazhdimisht se është e bindur që antipatia e anglezëve ndaj saj është për shkak të ngjyrës së lëkurës). Dhe këtë e përsëriti më 4 gusht në rrjetin amerikan CBS, në intervistën e parë të çiftit pas asaj me Oprah Winfrey në vitin 2021, duke folur për anën e errët të mediave sociale dhe duke paralajmëruar nisjen e një projekti kundër bullizmit në internet.

Zemërimi i Dukës së Sussex-it, megjithatë, ka në objektin kryesisht qeverinë britanike dhe Ravec, Komitetin Ekzekutiv për Mbrojtjen e Mbretërve dhe VIP-ave, të cilët kanë ngecur që nga viti 2020 në vendimin për të ulur pragun e nivelit të mbrojtjes së garantuar për Dukën e Sussex-it përmes fondeve publike. Një prag i cili, për Harry-n, është i papranueshëm. Beteja ligjore, e nisur nga djali i dytë i Charles III në vitin 2022 për të marrë

eskortën e paguar nga taksapaguesit kur ai ndodhet në Mbretërinë e Bashkuar me familjen e tij, përfundoi me vendimin përfundimtar të Gjykatës së Lartë Britanike i shpallur në shkurt, në të cilin u përsërit se ai nuk ka të drejtë dhe se “nuk ka asnjë mungesë legjitimiteti apo irracionalitet në vendimin e marrë”. Kërkesa e avokatëve të princit u refuzua në prill. Pikë.

Fruka nga të çekuilibruarit

Por Harry nuk dorëzohet. Nga njëra anë, e pushton malli për shtëpinë; dhe pastaj është babai Charles, i cili është i sëmurë me kancer: a nuk do të ishte mirë që fëmijët e tij ta shihnin përsëri gjyshin, para se të ishte tepër vonë? Nga ana tjetër, është i tmerruar, nga frika mos shëruan e tij të goditet me thikë ose


acid nga ndonjë i çmendur. Shpresa e vetme është që mbreti, një ndërhyrës i njohur kur bëhet fjalë për çështjet politike, të flasë në favor të djalit të tij me ministrat e qeverisë së re laburiste të Keir Starmerit. Problemi është se Harry nuk mund ta kontaktojë as në telefon. Sovrani, në fakt, nuk i është përgjigjur telefonatave të të birit që nga shkurti. Sipas thashethemeve të publikuara nga People, në muajin maj, gjatë udhëtimit në Londër për të festuar përvjetorin e Lojërave Invictus, Harry donte të fliste me babanë, për betejën e tij ligjore për të patur shoqërim. Por takimi u anulua për shkak të “agjendës së ngjeshur të mbretit”. Kështu që, të dy nuk kanë folur që nga takimi i tyre i fundit kokë më kokë. “Telefonatat e Harryt mbeten pa përgjigje, përfshirë ato në lidhje me shëndetin e sovranit”. Princi është i bindur se «i vetmi person që mund ta ndihmojë është babai i tij. Ai dëshiron të mbrojtë familjen

me çdo kusht”. Pallati Buckingham ka bërë të ditur se ideja që mbreti mund të bëjë diçka për Harry-n është “e pamundur”, sepse fjala e fundit i përket Ravec. Dhe telefoni i princit ndërkohë vazhdon të bjerë.

Kujtimi i Dianës përndjek Charles-in

Sovrani, nga ana e tij, “ka frikë se historia e Dianës do të përsëritet: ai nuk dëshiron që betejat e Harryt të rrëmbejnë faqet e para duke errësuar punën e tij siç ndodhi në kohën e divorcit me Diana Spencer”. Po William? Imagjinoni, ai nuk u përgjigjet telefonatave të vëllait prej vitesh. Edhe pse, sërish sipas People, situata mes tyre “është e keqe por jo e pariparueshme”.

Çelësi për të ndrequr marrëdhënien e tyre duket se është, edhe një herë, fiksimi i Harrit për sigurinë. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kuka i quan xhudistët heronj: Mbushët rrathët olimpikë me medalje



PEJE, 13 GUSHT - Trajneri i njohur i xhudos, Driton Kuka, i ka shprehur mirënjohje krejt ekipit të tij për sukseset e arritura në tri olimpiadat në të cilat Kosova ishte pjesëmarrëse. Kuka xhudistët i quajti heronj. “Ju faleminderit nga zemra! Mbushët rrathët olimpikë me medalje”, u shpreh Kuka. Kosova në tri Lojërat Olimpikë nuk shpëtoi pa marrë medalje. Në “Rio 2016” ishte “mbretëresha e xhudos”,

Majlinda Kelmendi, që ishte stolisur për herë të parë në historinë e xhudos së Kosovës me medaljen e artë. Katër vjet më vonë, dy xhudiste të tjera, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova, morën të artën në “Tokyo 2020”. Ndërkaq në “Paris 2024”, xhudistet Distria Krasniqi dhe Laura Fazliu i sollën vendit dy medalje, të argjendtën dhe të bronzit, duke arritur numri i përgjithshëm i medaljeve në pesë. “Mirënjohje

Majlindës e Fatosit për punën afër meje! Agronit, presidentit tonë, falënderim të veçantë. Klubit më të mirë në Botë, një falënderim i veçantë nga Judo Team Ippon-Peja, We make Champions of the World. Gjithë komunitetit të xhudos që jemi pak, por me vlera shumë. Komiteti Olimpik e Ministria e Sportit ishin afër nesh me përkrahje sa herë kishim nevojë!”, ka shtuar Kuka.

SHKURT

UEFA ia beson Nuzës edhe një ndeshje në Ligën e Konferencës

Gjyqtarit të Kosovës, Genc Nuzës, i besohet nga UEFA edhe një tjetër ndeshje në Ligën e Konferencës, raundi i tretë. Puskas Akademia – Ararat Armenia është ndeshja që do të gjykohej nga gjyqtari i Kosovës, Genc Nuza. Në ndeshjen që do të zhvillohet në stadiumin “Pancho Arena” të Felcsut, gjyqtarin Nuza do ta asistojnë Fatlum Berisha dhe Bujar Selimaj, ndërsa gjyqtar i katërt do të jetë Ilir Mehmeti. Edhe në këtë ndeshje do të ketë VAR dhe AVAR nga Kosova, ku do të jenë gjyqtari Dardan Çaka dhe asistenti Besnik Morina. Kjo ndeshje do të zhvillohet të enjten, më 15 gusht, me fillim në orën 21:00.

Rashad Williams përforcon KB Prishtina

KB Sigal Prishtina po vazhdon prezantimin e përf forcimeve të huaja për sezonin e ri në Superligën e Kosovës në basketboll. Klubi nga kryeqyteti ka zyrtarizuar fundorin amerikan Rashad Williams. Williams transferohet te Prishtina dhe vjen nga universiteti amerikan Arkansas që ka luajtur në NCAA 1, me një mesatare prej 17 pikëve për ndeshje. Williamsi është përf forcimi i tretë i huaj te Prishtina brenda pak ditëve, pasi klubi nga kryeqyteti po kompletohet për t’i filluar përgatitjet për sezonin e ri në drejtimin e trajnerit Murat Bilge. Para Williamsit, Prishtina ka prezantuar edhe dy amerikanë të tjerë, Damiree Burns dhe Jalen Moore, të cilët do ta kenë vitin e parë si profesionistë në Kosovë.

Berisha vazhdon kontratën me Akhmat Grozнын

Anësori i Përfaqësueses së Kosovës, Bernard Berisha, ka njoftuar se ka vazhduar kontratën me klubin Akhmat Grozny. Berisha ka shkruar në “Facebook” se ai do të jetë pjesë e klubit rus deri në vitin 2027. “Jam shumë i lumtur të njoftoj se kam vazhduar kontratën me klubin tim deri në vitin 2027. Zoti është i madh!”, ka shkruar Berisha. 32-vjeçari është pjesë e Akhmat Grozny që nga viti 2017, kur iu bashkua nga Anzhi. Me Akhmat Grozny në këtë sezon që sapo ka nisur në elitën e futbollit rus dhe Kupën e Rusisë, Berisha ka katër paraqitje në fushën e lojës, derisa ka shënuar dy gola, të dyja në Kupë. Më herët në karrierën e tij, Berisha ka djersitur fanellën e Skënderbeut, Teutës dhe Besës së Pejës dhe asaj të Kavajës.

Sot ndeshja e parë e Kosovës në Botërorin U18

PRISHTINË, 13 GUSHT - Çdo gjë është gati për Kampionatin e dhjetë Botëror për hendbollistët e reja (U18) që do të mbahet në Chuzhou të Kinës prej 14 deri më 25 gusht. Pjesë e kësaj ngjarjeje globale është edhe Kombëtarja e Kosovës, e kualifikuar përmes IHF Trophy. Gjithsej janë tetë grupe

me nga katër ekipe kombëtare. Kosova U18 është në Grupin D së bashku me Francën, Brazilin dhe Indinë. Ndeshjet do të zhvillohen në tri arena të ndryshme: Chuzhou International Handball Hall (me kapacitet prej 7000 vende), Chuzhou Olympic Sports Center (6488) dhe Chuzhou

Vocational and Technical College Stadium (3600). Të mërkurën, më 14 gusht, vashat e Kosovës luajnë ndaj Brazilit. Ndeshja zhvillohet nga ora 16:00 në arenën me 3 600 ulëse. Ndërsa të enjten Kosova nga ora 16:00 përballlet me Francën. Ndërkohë të shtunën e ardhshme nga ora 14:00 është ndeshja India -

Kosova. Më pas janë edhe ndeshjet për plasman. Grupi është shumë sfidues, por Kosova U18 ka bërë përgatitjet e duhura për paraqitje sa më të denjë në Botëror. Paraqitja në Botërorin në Kinë është sukses tjetër historik i Federatës së Hendbollit të Kosovës.



Duranti futet në botën e futbollit, bëhet aksionar në PSG

PARIS, 13 GUSHT - Ylli amerikan i basketbollit, Kevin Durant, do të bëhet një aksionar pakice në Paris Saint-Germain, duke shënuar sipërmarrjen e tij të parë të madhe në futbollin evropian. Vetëm pasi fitoi medaljen e katërt të artë olimpike në Paris, Durant do t'i

bashkohet ekipit të lojtarëve të NBA-së që investojnë në klubet më të mira të futbollit, siç është pjesëmarrja e LeBron Jamesit në Liverpool. Ndërsa përqindja e saktë e pronësisë së tij nuk është bërë e ditur, përfshirja e Durantit pritet ta rrisë profilin e PSG-së në Shtetet e Bashkuara. Ky nuk

është thjesht kapital, por një partneritet strategjik që mund ta forcojë markën e klubit, veçanërisht kur ai përgatitet për Kupën e Botës për Klube 2025 që do të mbahet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kujtojmë se Duranti erdhi në ligën e NBA-s në vitin 2007 dhe

tash e sa vite ka statusin e njërit prej yjeve më të mëdhenj të basketbollit dhe me kontrata të pasura ka marrë vlerën e pasurisë së tij, e cila llogaritet në 300 milionë dollarë. Ai ka luajtur në të gjitha edicionet e Lojërave Olimpikë që nga Londra 2012 dhe në karrierën e tij në klub ka



fituar dy unaza kampionati të NBA-s me Golden State, të dyja si MVP i finaleve.

Konkurrentja më e 'keqe' e Lojërave Olimpikë do të bëjë miliona euro si një sensacion interneti

PARIS, 13 GUSHT - Breakdancerja australiane Rachael Gunn, e cila "u bë e famshme" në Lojërat Olimpikë në Paris me një performancë katastrofike, do të fitojë miliona nga fama e saj e sapogjetur, thonë ekspertët e marketingut.

Rachel Gunn, ose emri i skenës Raygun me të cilin performoi në Paris, u bë një sensacion në internet për shkak të performancës së saj që nuk fitoi asnjë pikë. Gjyqtarët panë me mosbesim tri shfaqjet e Raygun në të cilat ajo kërcëu si kangur dhe rrotullohej në dysHEME jashtë ritmit dhe shikuesit u tronditën nga performancat e saj dhe ajo mori shumë kritika në rrjetet sociale. Australia u mbrojti duke thënë se çdo lëvizje e sajonte vetë dhe se ishin unike dhe në fund i sollën famë të madhe, e cila, sipas ekspertit të marketingut Max Markson, do ta bëjë atë milionere. "Ajo tashmë ka një markë të madhe. Reputacioni i saj në Australi nuk është aq i madh, por ajo është e njohur në të gjithë botën. Ajo do të marrë oferta



ndërkombëtare nga markat e këpucëve sportive si Adidas ose Puma, kompani ushqimore, makina elektrike dhe do të marrë një ofertë nga bota e telekomunikacionit. Yjet e rinj nënshkruajnë kontrata me tre deri në pesë kompani, dhe meqenëse kontrata të tilla paguajnë rreth 500 000 dollarë, ajo është në rrugën e duhur për të fituar deri në 2.5 milionë dollarë". "Ajo ka doktoruar në shkenca, ka shumë përvojë, kështu që do të marrë edhe angazhime në të folur. Gjithashtu, ajo është tërheqëse për fëmijët dhe të gjithë do të duan ta sjellin

në TV. Do të ketë paraqitje në TV për të në gjashtë muajt e ardhshëm", ka thënë Markson. Ditët e fundit në rrjetet sociale është bërë bujë e vërtetë, madje fansat e kanë kritikuar se ka zënë vendin e një breakdancere të talentuar australiane në Lojërat Olimpikë. Megjithatë, ka nga ata që besojnë se Raygun qëllimisht bëri shaka me performancën e saj për t'u bërë e njohur. Performanca e saj tërhoqi komente edhe nga ylli i famshëm britanik i muzikës Adele, e cila e përshkroi gjithçka si "gjëja më qesharake ndonjëherë".

Flamuri olimpiq mbërrin në Los Anxhelos

LOS ANXHELOS, 13 GUSHT - Franca u dha lamtumirën të hënën Lojërave Olimpikë, pas dy javëve magjepsëse, ndërsa sportistët u kthyen në shtëpi pas performancave të tyre në shfaqjen më të madhe në planet. Ndërkohë, bashkë me atletë dhe zyrtarë amerikanë, në bordin e Delta Airlines që zbriti të hënën në Los Anxhelos ishte dhe flamuri olimpiq, që do të valëvitet në vitin 2028, kur qyteti t'i presë Lojërat e ardhshme Verore. Me këngën "California Love" në pistën e Aeroportit Ndërkombëtar të Los Anxhelosit, kryetarja e bashkisë së Los Anxhelosit, Karen Bass, doli nga avioni e veshur me tuta të kuqe të Team USA, ndërsa u shpreh se është "krenari dhe përgjegjësi e jashtëzakonshme" që iu dha flamuri olimpiq në Paris të dielën.



Organizatorët amerikanë tani e ndiejnë vërtet "nevojën për të vënë këmbën në gaz", ka thënë ajo. Komiteti Olimpik Ndërkombëtar i dha Los Anxhelosit të drejtën në vitin 2017 për të pritur Lojërat 2028. Do të jetë hera e tretë që LA do t'i

presë Lojërat në epokën moderne, pasi ishte qyteti pritës më 1932 dhe 1984. Problemi i të pastrehëve është një ndër sfidat që duhet kapërcyer deri më 2028, ndërsa një tjetër sfidë është përballë trafikut të rënduar në qytet.

SHKURT

Vinicius Jr refuzon ofertën e majme nga Arabia Saudite

Arabia Saudite ka tentuar ta joshë Vinicius Jr, por sulmuesi i Realit të Madridit ka refuzuar propozimin e çmendur, duke preferuar qëndrimin te "Los Blancos". Al Ahli është klubi që provoi ta tundonte goleadorin latin me një ofertë të majme në aspektin financiar. Arabët i ofrojnë lojtarit një kontratë pesëvjeçare me një pagë sezonale rreth 200 milionë euro. Ndërkohë që aktualisht përfiton rreth 11 milionë euro në sezon në La Liga. Vinicius, i cili ka një klauzolë shitjeje 1 miliard euro, nuk ka ndërmend të lëvizë nga Reali, teksa as drejtuesit e klubit legjendar nuk duan të privohen nga shërbimet e tij. Sulmuesi u transferua më 2018 nga Flamengo në Madrid për 45 mln euro dhe deri tani numëron 93 gola në 263 ndeshje në të gjithë kompeticionet me ekipin e Carlo Ancelottit.

Alvarezi paraqitet tek Atletico Madridi

Julian Alvarez edhe zyrtarisht është transferuar në Atletico Madrid për 95 milionë euro nga Manchester City. 24-vjeçari do t'i kushtojë Atelticos fillimisht 75 milionë euro, plus deri në 20 milionë euro në shtesa të arritshme, dhe do të bëhet nënshkrimi i dytë më i shtrenjtë në historinë e tij pas Joao Felixit. Alvarez shënoi 36 gola në 103 ndeshje në një qëndrim dyvjeçar te City, duke e mbyllur sezonin e kaluar me 19 gola dhe 13 asistime në 54 paraqitje.

Martinezi vazhdon kontratën me Interin

Sulmuesi argjentinas Lautaro Martinez (26) ka vazhduar kontratën me Interin deri në vitin 2029. "Interi konfirmon se ka arritur marrëveshje për vazhdimin e kontratës me Lautaro Martinez. Martinezi nënshkroi një kontratë që skadon më 30 qershor 2029", thuhet në njoftimin e Interit. Martinezi mbërriti në "San Siro" në vitin 2018 nga Racing e Argjentinës për 23 milionë euro. Në 282 paraqitje për Interin, Martinezi shënoi 103 gola në të gjitha garat, duke fituar dy tituj kampionë italianë (2021 dhe 2024) dhe dy edicione të Kupës së Italisë (2022 dhe 2023).

De Gea: Nuk mendova asnjëherë për pensionim

Portieri spanjoll David de Gea ka folur për herë të parë si lojtar i Fiorentinës. Pas 12 vjetësh te Manchester Unitedi, ai u largua si lojtar i lirë dhe mbeti një vit pa klub, mirëpo tani ka zgjedhur Serinë A. "Manchester Unitedi është një top, top klub dhe zemra ime do të jetë gjithmonë aty", ka thënë De Gea. "Kurrë nuk e kam menduar pensionimin. Ishte e vështirë të gjej frymëzim për një kaptinë të re pas 12 vjetësh te një top klub si Manchester Unitedi. Dhe më në fund e ndjeva këtë gjë te Fiorentina", ka thënë De Gea.

Beieri nga Hoffenheimi kalon te Dortmundi

Sulmuesi Maximilian Beier është përforcimi më i ri i Boussia Dortmundit. Lajmin për transferimin e Beierit e ka dhënë

klubi gjerman. Beier i ka kaluar testet mjekësore dhe ka nënshkruar kontratë pesëvjeçare. Ai u transferua nga Hoffenheimi

për 28 milionë euro. "Jam shumë i emocionuar që do të bëj këtë hap tjetër madhor në karrierën time. Kam pasur një ndjenjë fantastike

që nga momenti kur fola për herë të parë me Dortmundin, sepse mund të them se ata vërtet donin të më sillnin këtu. Jam krenar që

tani do të luaj për një nga skuadrat më të mira në Evropë dhe mezi pres të filloj", ka thënë Beier.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kojshia” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811302926 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kojshia” D.O.O. Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811302926 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Kojshia” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811302926 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Valmir Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl VI - IX shfmu “Brigada 125 “ Medvec.

- Shkelqim Memaj shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën , certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

- Agush Kastrati shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X. QK “11 Marsi” Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

